



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.69

16 qershor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK
nr.21, datë 7.6.2007

Me objekt shfuqizimin e nenit 42 pika 5 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si i papajtueshëm me Kushtetutën..... 1953

Vendim i GJK
nr.22, datë 7.6.2007

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.624, datë 17.5.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.908, datë 26.5.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën..... 1959

Vendim i GJK
nr.23, datë 8.6.2007

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.4147, datë 17.9.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.476, datë 11.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.847, datë 29.6.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën..... 1962

VENDIM
Nr.21, datë 7.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtar e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 20.12.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çëshjen nr.50/20 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Enkelejd Alibej, me autorizim.
2. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Idar Bistri, me autorizim.
3. KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga Luan Dervishi, me autorizim.

4. EDMOND GOGO, përfaqësuar nga avokat Dashamir Kore, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 42 pika 5 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e dispozitës së lartpërmendur, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur sa vijon:

- Ligji nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 42 pika 5, që bën fjalë për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, parashikon se: “Për shkelje të disiplinës, si dhe për akte e sjellje të tjera diskretituese mund të merret si masë disiplinore dhe transferimi në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët”.

- Kushtetuta në nenin 147, pika 4, parashikon se Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë disiplinore sipas ligjit e se transferimi i gjyqtarit nuk mund të bëhet pa pëlqimin e tij, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit të drejtësisë.

- Kushtetuta e ndan transferimin nga masat disiplinore dhe vendos rregullin e përgjithshëm ndalues për transferimin e gjyqtarëve pa pëlqimin e tyre, me përjashtim të rasteve për nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Duke qenë kështu, dispozita e ligjit të lartpërmendur atakon Kushtetutën, prandaj duhet të konsiderohet e papajtueshme me të.

Përfaqësuesit e Kuvendit të Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave parashtruan se:

- Gjykata nuk ka qenë në kushtet e parashikuara nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

- Neni 42/5 i ligjit që është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor nuk bie ndesh as me parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, e as me konceptin që ka Kushtetuta për pavarësinë e gjyqtarëve.

- Në mjaft vende dhe nga disa Kushtetuta të tyre parashikohet transferimi edhe si masë disiplinore.

Përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka pretenduar se:

- Gjykata, që është nismëtare për këtë kontroll, nuk është ndodhur në kushtet e nenit 145 të Kushtetutës dhe këtë fakt e kanë nënvizuar edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin e tyre;

- Gjykata para së gjithash duhej të shprehej për pretendimin që kemi paraqitur në lidhje me mungesën e juridiksionit;

- Vendimi i Gjykatës është ankimuar prandaj, përsa i përket këtij pretendimi duhej që të shprehej më parë Gjykata e Lartë;

- Nocioni i transferimit që gjendet në nenin 147 të Kushtetutës nuk duhet të ngatërrohet me atë që ka ligji në lidhje me të si masë disiplinore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi Edmond Goga, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka kërkuar: rivendosjen në afat të padisë; kundërshtimin e vendimit nr.175/2, datë 28.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; pezullimin e zbatimit të vendimit të mësipërm; kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e diferencës së pagës.

Në seancën e datës 14.7.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pasi ka dëgjuar kërkesin që ka kërkuar pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese, për t'u shprehur kjo e fundit për papajtueshmërinë e nenit 42/5 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", me Kushtetutën, ka vendosur pranimin e kërkesës së tij, pezullimin e gjykimit të çështjes e dërgimin e saj pranë Gjykatës Kushtetuese.

Bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës dhe në ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar ushtrimin e një kontrolli incidental rreth pikës 5 të nenit 42 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; sipas të cilit "Për shkelje të disiplinës si dhe akte e sjellje të tjera diskredituese merret si masë disiplinore, ndër të tjera, edhe transferimi në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel ose të një niveli më të ulët".

Në mënyrë të përmbledhur kërkuesi ka parashtruar se Kushtetuta jo vetëm që e ndan transferimin nga masat disiplinore, por përkundrazi vendos rregullin e përgjithshëm ndalues për transferimin e gjyqtarit pa pëlqimin e tij, me përjashtim të rastit kur ai bëhet për nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Sipas kërkuesit, transferimi si masë disiplinore sjell efekte dhe pasoja jo vetëm për atë, por edhe për komunitetin e qytetarëve, të cilët kanë të drejtë të përfitojnë të njëjtën cilësi shërbimi nga organet gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese e sheh me vend që t'i referohet praktikës së saj të mëparshme në lidhje me funksionin kushtetues që përmbushin gjyqtarët, të cilët nga Kushtetuta dhe ligji janë të ngarkuar me dhënien e drejtësisë. Kushtetuta, duke parashikuar një standard të rëndësishëm për mbrojtjen e statusit të gjyqtarëve, është përqendruar vetëm në trajtimin e transferimit e të shkarkimit të tyre nga detyra, pa bërë fjalë edhe për masat e tjera disiplinore. Për këto raste, norma kushtetuese zbatohet drejtpërsëdrejti.

Përjashtimi kushtetues i parashikuar në nenin 4 pika 3 të Kushtetutës, nënkupton se normat kushtetuese mund të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti kur Kushtetuta ka ngarkuar organet shtetërore për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e

marrëdhënieve në fusha të ndryshme.¹

Gjykata Kushtetuese, veç kësaj, e çmon të nevojshme të përqendrohet në mënyrën e formulimit të nenit 147, pikat 4, 5, të Kushtetutës. Sipas pikës 4 të këtij neni: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore, sipas ligjit”; ndërsa sipas pikës 5 “Transferimi i gjyqtarëve nuk mund të bëhet pa pëlqimin e gjyqtarëve, përveçse kur këtë e diktojnë nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor. Siç shihet, kjo dispozitë përcakton dy nga kompetencat e rëndësishme (përfshijtur kompetencën për të vendosur për shkarkimin e tyre nga detyra) që ka Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që janë: transferimi i gjyqtarëve dhe marrja e masave disiplinore.

Kushtetuta e ka trajtuar transferimin si një mjet të nevojshëm që mund të përdoret vetëm me pëlqimin e gjyqtarit ose për nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor (për të cilin nuk është e domosdoshme marrja e pëlqimit të tij).

Por, veç këtyre, pika 4 ka zgjidhur dhe një problem tjetër të rëndësishëm, duke ngarkuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë për të vendosur edhe për masat disiplinore.

Gjykata Kushtetuese është shprehur se kjo dispozitë kushtetuese përmban elementet e një norme referuese, për shkak se mënyrën e transferimit të gjyqtarëve dhe përgjegjësinë e tyre disiplinore ia ka deleguar ligjvënësit, duke pranuar se ligjvënësit i është dhënë e drejta që nëpërmjet ligjeve të rregullojë në mënyrë të hollësishme çështjet që përfshihen vetëm në këto dy drejtime të specifikuara.

Është e vërtetë se në rastin e parashikuar pika 4 e nenit 147 të Kushtetutës, nuk shprehet drejtpërdrejt për transferimin edhe si masë disiplinore, por për këtë problem të rëndësishëm ajo referon te ligji konkret; ndërsa në nenin 42 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen masat që mund të merren nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në rast se vërtetohen rrethanat e përgjegjësisë disiplinore po sipas këtij ligji.

Pavarësisht se përdoret i njëjti term, transferim, ai në përmbajtjen e tij nuk nënkupton të njëjtën gjë, pasi nuk bëhet fjalë për transferim me pëlqimin e gjyqtarit dhe as për transferim për nevojat e riorganizimit të sistemit gjyqësor, por për një lloj transferimi që përdoret si një masë disiplinore ndaj gjyqtarit. Për këtë ligjvënësi mund të kishte përdorur edhe një term tjetër siç mund të ishte dërgimi në një gjykatë tjetër ose lëvizja në një gjykatë tjetër etj. Me qëndrimet që mban Kushtetuta për transferimin që, si rregull, kërkon pëlqimin e gjyqtarit, ajo indirekt siguron, jep garanci për pavarësinë e tij. Duke bërë një përjashtim për rastet kur bëhet fjalë për riorganizimin e sistemit gjyqësor, ajo vë në balancë interesat e tij vetjake me ato publike që lidhen drejtpërsëdrejti me mosfunksionimin e një gjykate konkrete të këtij sistemi.

Por, pavarësisht nga fakti se Kushtetuta nuk e ndalon transferimin edhe si masë disiplinore, që mund të kishte edhe me një emërtim tjetër; për çështjen në shqyrtim, merr rëndësi fakti tjetër që ka të bëjë me mënyrën se si ligji i ka konceptuar masat disiplinore për gjyqtarët.

Masat disiplinore që merr Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë karakter të përkohshëm, por i shërbejnë funksionimit normal të veprimtarisë së gjykatave. Si të tilla ato i shërbejnë edhe rehabilitimit të gjyqtarit të ndëshkuar.

Gjykata Kushtetuese është e detyruar ta ballafaqojë këtë koncept me atë që ka transferimi sipas doktrinës e sipas legjislacionit të kohës edhe në vendet e tjera. Në këtë proces, kjo gjykatë vëren se në dispozitën e kundërshtuar, transferimi është parashikuar si një masë disiplinore me karakter të përhershëm, njëlloj sikur të ishte një marrëdhënie e re pune me afat të pacaktuar. Ky qëndrim bie ndesh me konceptin që ka transferimi që karakterin e përkohshmërisë e ka si një ndër elementet e domosdoshme të tij. Kjo kërkesë është shumë e rëndësishme sepse edhe nga ekzistenca ose jo e saj, kjo masë dallon nga largimi nga puna.

Veç kësaj, ligji nuk ka parashikuar as mundësinë që kjo masë të parashkruhet me kalimin e një afati të caktuar. Ndryshe nga sa konstatohet në legjislacionin e vendeve të

¹ Shih, vendimin nr.29, datë 30.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

ndryshme në përgjithësi janë vendosur afate me kalimin e të cilave masat disiplinore në përgjithësi dhe transferimi në veçanti, parashkruhen dhe gjyqtarët ndaj të cilëve merren ato, nuk konsiderohen si të ndëshkuar.

Gjykata Kushtetuese konstaton se edhe vetëm fakti që transferimi nuk është konceptuar konform standardeve të duhura kushtetuese, e bën këtë dispozitë si të papajtueshme me Kushtetutën, prandaj për këto arsye duhet shfuqizuar.

Pas kësaj Kuvendi i Shqipërisë duhet të vlerësojë nëse do ta mbajë atë me ndonjë emërtim tjetër edhe si masë disiplinore apo do ta zëvendësojë me ndonjë masë tjetër që Kuvendi duhet të modifikojë qëndrimin e tij, duke përcaktuar se ajo ka karakter të përkohshëm e se duhet të parashkruhet me kalimin e një afati të arsyeshëm ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 78 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të pikës 5 të nenit 42 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër mendimit të shumicës, por kemi mendim paralel edhe me pakicën që është për rrëzimin e kërkesës.

Kërkuesi Edmond Gogo, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe ka kërkuar rivendosjen në afat të padisë; kundërshtimin e vendimit nr.175/2, datë 28.4.2005 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; pezullimin e zbatimit të vendimit të mësipërm; kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe pagimin e diferencës së pagës.

Gjykata fillimisht e ka pezulluar gjykimin e çështjes me arsyetimin se një kërkesë tjetër e kërkuesit me të njëjtin objekt: Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndodhej për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Që në fillim të shqyrtimit të çështjes, kërkuesi ka kërkuar rivendosjen në afat të kërkesës, por gjykata nuk është shprehur për këtë.

Po ashtu, përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke pretenduar se gjykata nuk kishte juridiksion për ta gjykuar këtë kërkesë, ka kërkuar që kjo e fundit të shprehej për mungesën e juridiksionit të saj për çështjen objekt gjykimi.

Në seancën e datës 14.7.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka dëgjuar përfaqësuesin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është shprehur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor; ka dëgjuar kërkuesin, i cili ka kërkuar pezullimin e gjyqimit të çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese, për t’u shprehur për papajtueshmërinë e nenit 42/5 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me Kushtetutën, dhe në përfundim ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit, pezullimin e gjyqimit të çështjes dhe dërgimin e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese.

Edhe gjatë kësaj seance Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është shprehur për rivendosje në afat të kërkesës, dhe as për pretendimin për mungesën e juridiksionit të saj për çështjen në gjykim.

Kundër vendimit të pezullimit ka paraqitur ankim Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit për mungesë juridiksioni gjyqësor për shqyrtimin e një kërkesë të tillë. Ky ankim aktualisht ndodhet për gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Duke pasur parasysh këto rrethana të çështjes, të cilat nuk janë pranuar nga shumica, e as nuk janë evidentuar në vendim, jemi detyruar për t'u shprehur kundër saj. Nga ana tjetër kemi mendim paralel me pakicën, e cila ka qenë kundër pranimi të kërkesës për thelbin e saj.

Mendimi ynë ka të bëjë me dy probleme të karakterit procedural, që për çështjen objekt gjykimi incidental nga Gjykata Kushtetuese, marrin rëndësi të veçantë, aq sa e bëjnë kërkesën të papranueshme, sepse për këto shkaqe kjo kërkesë është e pabazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës.

Sipas nenit 145/2 të Kushtetutës, kur gjatë gjykimit të një çështjeje gjyqtari çmon se ligji mbi bazën e të cilit gjykon, vjen në kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë, por e pezullon gjykimin e çështjes dhe ia dërgon atë Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën.

Në lidhje me mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ka krijuar një praktikë të saj, që në thelbin e vet ka të bëjë me përpunimin e sistemit të disa kërkesave apo kushteve që duhen repsektuar nga gjykata nismëtare për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

Kërkesat e nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në tërësi kanë rëndësinë e tyre, por në këtë mendim pakice do të evidentojmë disa kërkesa me karakter procedural.

1. Mendojmë se që gjykata të vendosë për të pezulluar gjykimin e çështjes dhe dërgimin e saj para Gjykatës Kushtetuese, para së gjithash, duhet të ketë për gjykim një çështje që është në kompetencën e saj. Në rastin konkret, për aq kohë sa gjykata me cilësinë e kërkuarit nuk është shprehur me vendim të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës, për rivendosjen në afat, ajo nuk ka çështje për t'u gjykuar e për pasojë, nuk mund të legjitimohet për të paraqitur kërkesën konkrete para Gjykatës Kushtetuese. Pra, fakti që ajo nuk ka rivendosur në afat kërkuarin, ka aq rëndësi për çështjen sa nuk e lejon gjykatën të vazhdojë hetimin gjyqësor e të merret me provat që i sjellin palët për të vërtetuar apo prapësuar pretendimet e tyre në lidhje me themelin e çështjes.

2. Me rëndësi për çështjen është fakti se gjykata që ka dërguar këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese, që në fillim të gjykimit të çështjes ka dëgjuar pretendimin e palës së paditur se ajo nuk kishte juridiksion për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi e se duhej ta nxirrte atë jashtë juridiksionit gjyqësor. Gjykata nuk e ka zgjidhur këtë problem me rëndësi, pa zgjidhjen e të cilit nuk mund të bëhet fjalë për juridiksion gjyqësor e për gjykatë kompetente. Ne mendojmë se veç problemit që kishte të bënte me kërkesën për rivendosje në afat, gjykata duhej të zgjidhte mundësisht që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, por patjetër para se të ndërmernte iniciativën për të dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese, për të ushtruar kontroll incidental, problemin e juridiksionit të saj për të cilin, pala e paditur si kërkesë paraprake ka paraqitur pretendimin në lidhje me juridiksionin. Është e vërtetë se neni 59 i Kodit të Procedurës Civile e lejon gjykatën që problemin e juridiksionit mund ta zgjidhë deri në përfundim të hetimit gjyqësor, por ajo kurrësi nuk duhej të spekulonte me këtë të drejtë. Përmbajtja e kësaj dispozite ka për qëllim që të mos pengojë gjykatën për ta zgjidhur atë problem deri në atë fazë, duke pasur parasysh faktin se mund të ndodhë që një pretendim si ai të lindë, e të bëhet edhe gjatë hetimit gjyqësor, por kur ai bëhet i pranishëm që në fillim të shqyrtimit të çështjes, domosdo ai duhet të zgjidhet në fillim të shqyrtimit të saj, sepse në varësi me qëndrimin që do të mbahet ndaj këtij problemi, do të konkludohet nëse do të ketë

apo jo çështje për gjykatën.

3. Jemi kundër mendimit të shumicës dhe për argumentin tjetër, që ka të bëjë me vlerësimin e trajtimit e raportit të hierarkisë së normës kushtetuese (neni 145/2 i Kushtetutës) dhe normës procedurale (neni 298 i Kodit të Procedurës Civile), që bën fjalë për pezullimin e gjykimit të çështjes. Neni 145/2 i Kushtetutës është një normë me karakter procedural që për shkak të rëndësisë së veçantë është parashikuar si normë kushtetuese. Ajo ka për qëllim të krijojë një vizion të ri në lidhje me pushtetin e gjyqtarëve ndaj ligjit kur konstatojnë se ai është i papajtueshëm me Kushtetutën. Pa qenë e nevojshme për të trajtuar me detaje këtë raport normash, ne mendojmë se gjykata para së gjithash duhej të respektonte kërkesat e dispozitës kushtetuese që kërkon që gjykata që gjykon një çështje duhet të ketë juridiksion, të jetë kompetente për të gjykuar çështjen konkrete e veç këtyre kërkesave, të ketë lidhje midis çështjes që gjykohet dhe ligjit që çmohet se është i papajtueshëm me Kushtetutën. Në rastin konkret, mosvlerësimi i këtyre kërkesave të karakterit kushtetues e procedural krijon mundësinë që gjykata të abuzojë me kërkesa të tilla në zbatimin e kësaj kompetence.

Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese nuk duhej të pranonte e të shqyrtonte themelin e kërkesës për pajtueshmërinë e dispozitës konkrete, për aq kohë sa konstatoheshin këto mangësi me rëndësi të karakterit procedural. Gjykata kërkuese, pasi të plotësonte e zgjidhte këto pengesa procedurale, mund ta dërgonte çështjen për shqyrtim përsëri pranë Gjykatës Kushtetuese.

Për shkaqet e lartpërmendura kërkesa duhet rrëzuar.

Anëtarë: P. Plloçi, F. Abdiu

VENDIM **Nr.22, datë 7.6.2007**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“ “
Kristofor Peçi	Anëtar	i	“ “
Kujtim Puto	Anëtar	i	“ “
Vjollca Meçaj	Anëtare	e	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“ “
Alfred Karamuço	Anëtar	i	“ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 10.4.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.34 Akti, që i përket:

KËRKUES: SHOQËRIA “ARGINERT” SHPK TIRANË.

SHOQËRIA “STUDIOPROJEKT” SHPK TIRANË, të përfaqësuar nga avokatet Fatmira Luli e Hanëme Bakia, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: BASHKIA TIRANË, përfaqësuar nga Natasha Kondi e Albert Lenja, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.624, datë 17.5.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.908, datë 26.5.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/g e 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 16, 20/2 e 28 të Kodit të Procedurës Civile.

Kërkuesit parashtrojnë këto shkaqe kryesore në kërkesën e tyre:

- Gjykatat kanë anashkaluar prova me rëndësi vendimtare për procesin, si dhe kanë deformuar dhe kanë treguar njëanshmëri të hapur në pranimin e vlerësimit e provave.
- Gjykatat nuk kanë analizuar asnjë pretendim të kërkuesve, të referuara në prova shkresore dhe për më tepër kanë mohuar ekzistencën e tyre edhe pse ato ndodhen në dosje.
- Gjykatat kanë shkelur barazinë e armëve.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësueset e kërkuesve, përfaqësuesen e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesit, Shoqëria “Arginert” sh.p.k. dhe shoqëria “Studioprojekt” sh.p.k., kanë konkuruar në tenderin e hapur të shpallur nga Bashkia Tiranë me objekt “Zgjerim, sistemim-asfaltim, rehabilitimin e ujësjellës-kanalizimeve dhe rregullimin e trotuareve në rrugën “Punëtorët e Rilindjes”, shtrimin e trotuarëve në të dy krahët e Lanës, në segmentin nga Ura e Rugës së “Elbasanit” deri tek Ura Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”.

Palët kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes në datë 23.5.2001, ndërsa në datë 27.12.2001, janë kolauduar punimet pa ndonjë vërejtje, e mbi këtë bazë është mbajtur procesverbali.

Rezulton se gjatë kryerjes së punimeve objekt kontrate, Bashkia e Tiranës ka kërkuar nga firmat kontraktore, kryerjen e disa punimeve në segmentin nga Ura e “Rugës së Elbasanit” deri tek P.T.4, punë të cilat janë kryer dhe për të cilat mbi bazën e situacionit të paraqitur në kohën e dorëzimit të punimeve janë likujduar 14 % e vlerës së tyre.

Më pas, edhe pse objektet e mësipërme u morën në dorëzim, Bashkia nuk ka pranuar të likujdojë diferencën e palikujduar të vlerës për punimet në “Rrugën e Elbasanit”.

Kërkuesit kanë bërë padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr.4675, datë 11.11.2003, ka detyruar Bashkinë Tiranë me pagimin e vlerës së punimeve, si dhe të kamatvonesave.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.624, datë 17.5.2004, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e rrëzimin e padisë, vendim të cilin e ka lënë në fuqi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.908, datë 26.5.2005.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë janë rezultat i zhvillimit të një procesi të parregullt gjyqësor e si të tilla duhet të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën.

Në shqyrtimin e çështjes Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka respektuar parimin e barazisë së armëve në proces e për pasojë ka mbajtur një qëndrim tërësisht të njëanshëm. Duke iu referuar argumenteve të parashtruara në vendim, ballafaquar me provat e paraqitura nga kërkuesit qysh në gjykimin në shkallën e parë, del fare qartë konstatimi i mësipërm i Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata e Apelit Tiranë parashtrohet shprehimisht se Bashkia e Tiranës nuk ka dhënë pëlqim për punimet në “Rrugën e Elbasanit” dhe këtë e bazon tërësisht në dëshminë e dy punonjësve kryesorë në Bashki, drejtorit të Projekteve të Infrastrukturës dhe drejtorit të Punëve Publike. Gjykata shprehet gjithashtu se kërkuesit nuk paraqitën asnjë provë nga ku të vërtetohej pëlqimi me shkrim i Bashkisë për këto punime. Gjykata e Apelit nuk ka marrë në

shqyrtim një numër të konsiderueshëm provash shkresore të paraqitura nga kërkuesit e ndër të tjera dhe shkresën nr.452, datë 23.1.2002 në të cilën vetë Baskia ka dhënë opinion për cilësi të lartë të punimeve.

Veç thënieve të dëshmitarëve të mësipërm, gjykata e apelit vendimin e saj e argumenton edhe me konsiderata të përgjithshme pa i ballafaquar me provat e paraqitura nga kërkuesit. Kështu, në dosje ka prova shkresore nga del se vetë Këshilli i Ministrave miratoi fond shtesë për punimet dhe se ai u kalua me shkresën nr.669/1, datë 4.2.2002 të Ministrisë së Financave. Duke e injoruar këtë fakt, Gjkata shprehet se “porositësi është ent publik dhe në procesin e zbatimit të kontratës nuk mund të kryejë punime për të cilat nuk është i autorizuar t’i kryejë”.

Në vendimin e saj, Gjkata e Apelit Tiranë, duke iu referuar thënieve të dy dëshmitarëve, në mënyrë abuzive pranon se kërkuesit janë paralajmëruar të mos bënin punimet në Rrugën e Elbasanit”, dhe për këtë përmend shkresën nr.7667/1, datë 11.10.2002. Në fakt, por t’i referohesh kësaj shkrese, e cila është e administruar në dosje, ajo bën fjalë shprehimisht për punimet në objektin “Punëtorët e Rilindjes” e jo për objektin në konflikt dhe se në atë shkresë, drejtori i Punëve Publike tërhiqte vëmendjen e paralajmëronte për mosdorëzimin në kohë të situacioneve për efekte financiare. Duke e përdorur si provë këtë shkresë, gjykata njëkohësisht injoron faktin se në dosje ka të administruara si prova shkresore dokumente të Bashkisë të përpiluara pas datës që mban shkresa e lartpërmendur dhe se në ato kanë firmosur edhe përfaqësues të bashkisë (duke përfshirë edhe drejtorët) lidhur me punimet e kryera, mënjanimin e disa pengesave në terren, kolaudimin e veprës, etj. Po kështu, nga tre supervisorët e punimeve, përfaqësues të Bashkisë, janë nënshkruar rregullisht të gjitha situacionet ditore e ato përmbledhëse. Ata kanë nënshkruar edhe Librezat e Masave duke përshkruar cilësinë e punimeve dhe vëllimin e tyre.

Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke iu referuar materialeve të ndodhura në dosje dhe pretendimeve të pjesëmarrësve në proces, pranon se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një shtesë të kontratës së sipërmarrjes dhe se kërkuesit nuk mundet të vërtetojnë pretendimet e ngritura. Edhe pse fare i shkurtër, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, dëshmon për trajtim haptazi të njëanshëm të provave të paraqitura.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, si dhe e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mëse një herë kanë pranuar si elemente të qenësishme të procesit të rregullt gjyqësor respektimin e parimit të barazisë së armëve lidhur ngushtë me paanësinë në gjykim. Mbi bazën e këtyre standardeve, çdo palë në proces nuk duhet të gjejë avantazhe të konsiderueshme ndaj kundërshtarit, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë midis palëve. Në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë e atë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, standardet e përmendura janë cenuar ndjeshëm e për këtë shkak ato duhet të shfuqizohen si jo në përputhje me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjkata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.624, datë 17.5.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.908, datë 26.5.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.23, datë 8.6.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 21.2.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26 Akti, që i përket:

KËRKUES: LLAMBI AVALE, përfaqësuar nga avokate Fatmira Luli, me prokurë.
SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. ELSA POGA, përfaqësuar nga avokate Nurihan Meta, me prokurë.

2. ZYRA E VERIFIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr.4147, datë 17.9.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.476, datë 11.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.847, datë 29.6.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimeve, duke arsyetuar se është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës:

- Paditësja nuk legjitimohej në ngritjen e padisë.
- Është shkelur parimi i barazisë së armëve në proces.
- Është shkelur parimi i sigurisë juridike, pasi është lënë pa fuqi një vendim gjyqësor i formës së prerë.

- Padia nuk është gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

Në përgjigje të pretendimeve të mësipërme, subjekti i interesuar ka parashtruar:

- Gjykata Kushtetuese nuk ka detyrë të korrigjojë gabimet e organeve gjyqësore në interpretimin dhe zbatimin e ligjeve, por ndërhyr kur konstaton se janë shkelur parimet bazë të procesit civil.

- Mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme.

- Lidhur me pretendimin për shkeljen e parimit të barazisë së armëve, subjekti i interesuar ka parashtruar se pala kërkuuese i ka patur të gjitha mundësitë dhe i ka shfrytëzuar ato për të bërë kërkesat e veta dhe në asnjë rast nuk i është mohuar e drejta.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesen e kërkuarit, përfaqësuesen e

subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

E quajtura Elsa Poga ka ngritur padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt – pavërtetësi dokumenti – Vërtetim Pronësie – goditje për falsitet, në bazë të neneve 32 shkronja “c” dhe 270 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.4147, datë 17.9.2004, ka vendosur: Pranimin e padisë, duke deklaruar si të pavërteta dokumentet e regjistrimit të pronës, pasurisë nr.2/428 në zonën kadastrale nr.8270, truallit të ndodhur në Rr.“Sami Frashëri”, mbi të cilin është ndërtuar një lokal dykatësh, në emër të Llambi Avale.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.476, datë 11.4.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.847, datë 29.6.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e mësipërme janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe ka kërkuar shfuqizimin e tyre.

Në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese përqendrohet vetëm në ato pretendime që kanë të bëjnë me parimet themelore të procesit gjyqësor civil. Në këtë kuadër ka rëndësi të shqyrtohet pretendimi për shkeljen e parimit të barazisë së armëve në proces, si dhe pretendimi për shkeljen e parimit të sigurisë juridike si një aspekt i parimit të shtetit të së drejtës.

Me këtë rast Gjykata Kushtetuese thekson se barazia e armëve është një aspekt i rëndësishëm i konceptit të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ky parim nënkupton që secilës palë në proces t’i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur çështjen e vet (ku përfshihet edhe paraqitja e provave nga ana e saj), në kushte që nuk e vendosin atë në një disavantazh të dukshëm në raport me palën tjetër.

Parë nga perspektiva e këtyre konsideratave, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimi i mësipërm është i bazuar.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e tyre gjykatat e zakonshme i kanë bazuar vetëm në provat e palës paditëse, dhe nga ana tjetër nuk kanë administruar e vlerësuar edhe provat e tij. Në mënyrë të veçantë, kërkuesi ka parashtuar se gjykatat e zakonshme nuk kanë vlerësuar si provë vendimin nr.5972, datë 18.9.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili, sipas kërkuesit e njeh atë si pronar mbi truallin dhe lokalin.

Në kuadrin e shqyrtimit të këtij pretendimi, Gjykata Kushtetuese thekson se marrja dhe vlerësimi i provave është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Megjithatë, kjo Gjykatë ka detyrimin të vlerësojë nëse procesi gjyqësor i zhvilluar, në tërësinë e tij, përmbush kërkesat e një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Në mënyrë të veçantë, neni 42 i Kushtetutës i vë detyrë gjykatës së zakonshme të bëjë një shqyrtim të përshtatshëm të pretendimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin nëse këto prova janë të rëndësishme për vendimin e saj.¹

Në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se gjykatat e zakonshme nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit në vendimet e tyre. Në mënyrë të veçantë, gjykatat nuk kanë administruar si provë dhe nuk kanë arsyetuar në vendimet e tyre nëse vendimi gjyqësor i pretenduar nga ana e kërkuesit, ka ndonjë vlerë ligjore (efekt) në gjykimin e padisë për deklarimin e falsitetit të dokumenteve. Ky vendim është paraqitur si provë kryesore në këtë gjykim. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese konstaton se në këtë rast është

¹ Shih, Çështja *Van Kuck v. Gjermanisë*.

shkelur parimi i barazisë së mundësive në një proces civil.

Gjykata Kushtetuese konstaton gjithashtu se vlerësimi dhe arsyetimi nga ana e gjykatave, lidhur me vendimin gjyqësor të paraqitur si provë nga ana e kërkuarit, ka rëndësi edhe në kuadrin e respektimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton, që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim¹.

Parë në prizmin e këtyre konsideratave, Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjykatat e zakonshme duke mos trajtuar vlerën e vendimit gjyqësor nr.5972, datë 18.9.1995, kanë bërë të pavlefshëm një proces gjyqësor që kishte përfunduar me dhënien e këtij vendimi. Një gjë e tillë, nuk mund të bëhet pa dhënë arsytet edhe në vështirësi të nenit 451 shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile, i cili trajton detyrueshmërinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Për pasojë, mënjanimi i një vendimi të tillë pa dhënë asnjë arsytet, cenon besimin e individit të shteti dhe institucionet shtetërore, dhe për pasojë përbën cenim të parimit të sigurisë juridike.

Për sa sipër, vendimet e kundërshtuara duhet të shfuqizohen si jokushtetues dhe çështja të dërgohet për rigjykim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.4147, datë 17.9.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.476, datë 11.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.847, datë 29.6.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

¹ Shih, Vendimi *Brumarescu k. Rumanisë*, i 28 tetor 1999, par. 61 deri 63).

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 14.6.2007
Doli nga shtypi më 16.6.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë